



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 45/16

Prishtinë, më 18.02.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Adem Grabovci, Labinote Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Jelena Bontic, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Adem Grabovci, Ilir Deda, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi – Zëvendës -ministër i Financave.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Safet Hoxha-Kryetar KRPP, Ismet Krasniqi-Sekretar i Kuvendit të Kosovës, Fjolla Uka - nga KDI, Artë Muftari- Praktikante në Zyren e Presidentes, Resmije Balloshi Gazetare nga Ekonomia Online, Arta Rexha - Gazetare Rrokum TV, Petrit Dak-Kamerman në KTV, Ismail Shabani- Gazetar nga KosovaPress, Rrahman Rama- monitorues nga BIRN, Ekrem Pasjaqa-MediaPress, Kushtrim Ahmeti-Gazetare nga KTV, Blerta Bejtullahu nga Zyra e BE-së, Mentor Rusolli – Gazetar nga Ekspres, Rejhane Zylfijaj dhe Mentor Hyseni nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 10.02.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe nr.05/L-068;
4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtari Minerare dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-064 për Pantentë Shofer dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
7. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – propozojë që pika e shtatë e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër të komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës pa pikën shtatë.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 10.02.2016

Kryetari – konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe nr.05/L-068

Kryetari - ju e dini që ligji i prokurimit është njëri nga 8 kushtet e Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave. Në ligjin që kemi miratuar në muajin dhjetor janë bërë disa lëshime që mund të jetë edhe për shkak të gjendjes se si kemi punuar dhe angazhimeve të shumta të që kemi pasur në atë kohë. Sidoqë të jetë, qeveria ka propozuar ndryshimet dhe plotësimin e ligjit dhe në nenin 2 shifet se është rregulluar mënyra e emërimit të anëtarëve të OSHP-së, ku është përcaktuar që propozimet të vijnë nga Qeveria dhe emërimi bëhet nga Kuvendi, që është edhe ndryshimi thelbësor. Përveç kësaj është rregulluar edhe qështja e mënyrës së shkarkimit dhe ai që të emëron edhe të shkarkon. Një qështje që ka nevojë të rregullohet është ajo që ka të bëjë me vazhdimin e mandatit të anëtarëve të OSHP-së me ligj, deri sa të zgjidhen anëtarët e rinj. Unë mendoj se kjo është rregulluar gabimisht. Për këtë qështje jam konsultuar edhe me disa anëtarë të Komisionit për Legjislacion që thonë se mandati i anëtarëve të OSHP-së caktohet me vendim të Kuvendit për një kohë të caktuar dhe kur iu përfudon mandati ata nuk janë legjitim me marrë vendime. Prandaj kjo qështje duhet rregulluar. Siç thashë edhe në fillim, miratimi i këtij ligji është i lidhur me plotësimin e kushteve për liberalizimin e vizave dhe prandaj duhet të procedojmë me procedurë të përshpejtuar.

Agim Krasniqi – me këtë projektligj rregullohe dy gjëra kryesore. Qështja e parë ka të bëjë me rregullimin e lëshimeve që janë bërë në ligjin e kaluar, që ka të bëjë me emërimin e anëtarëve të OSHP-së. Ndryshimi tjetër ka të bëjë me përcaktimin e procedurave për shkarkimin e anëtarëve të OSHP-së, që është rregulluar me nenin 3.

Safet Hoxha – përveç përmirësimeve të lëshimeve që janë bërë lidhur me emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të OSHP-së, janë edhe disa qështja tjera që kanë nevojë të rregullohen me këtë projektligj. Ne i kemi propozimet konkrete të cilat i kemi diskutuar edhe me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së. Kërkesa është që në ligj të përfshihet edhe projekti ekzekutiv ose ne i perkufizojmë si dizajnë grafik. Organizatat e Shoqërisë Civile kanë kërkuar që të trajtohen si ogranizata jo qeveritare sepse ashtu e parasheh ligji. Sa i përket nenin 21/A duhet të rishikohet, pasi që është problem sepse ligji për menagjimin e financave publike apo sistemi i zotimeve e tjera, kërkojnë përcaktimin e zyrtarit të autoritetit kontraktuese të inicoj urdhërblertjen ne Pejroll. Te procedura konkurruese me negociata, kërkesa është të zgjaten afatet. Sa i përket emërimit të bordeve të KRPP-së dhe OSHP-së ne kemi një zgjidhje të përafert me zgjidhjen qe e ofroj kryetari i komisionit. Sa i përket zgjedhjes së anëtarëve të KRPP-ja është ajo që është në ligj. Por te shkarkimi, suspendimi apo largimi i tyre kemi vërejtje, sepse ai që të emëron edhe duhet të shkarkoj. Sa i përket numrit të anëtarëve të OSHP-së mendimi ynë është që ndoshta numri nga 5 të rritet në 7 anëtar, sepse kjo do të ketë ndikim në efikasitetin e paneleve shqyrtuese.

Safete Hadergjonaj - theksoi se është e pakuptueshme se si ka mundur me rrëshit një gjë e tillë, me u heq prej ligjit qështja e procedurës së emërimit dhe shërkarrimit të anëtarëve të OSHP-së, kur pikërisht një qështje e tillë është kërkuar nga Komisioni Evropian, e që ka të bëjë me plotësimin e kriterëve për liberalizimin e vizave. Unë e kuptoj që ky projektligj kërkohet të procedohet më shpejtë, por ndoshta ka qenë mirë të caktojmë një grup punues prej 3 vetash që deri ne momentin e miratimit të ligjit në lexim të dytë, të analizojmë atë me ndihmën edhe të ekspertëve ligjor që janë brenda Kuvendit dhe të shikojmë se qka mundemi të ndryshojmë apo rregullojmë që të bëjmë harmonizimet e nevojshme e që mandej mos të marrim vërejtje nga Komisioni Evropian.

Sa i përket neneve të projektligjit, në nenin 2, paragrafi 2 duhet të rregullohet dhe të caktohet një afat se kur duhet të bëhen zgjedhja e anëtarëve të OSHP-së, në mënyrë që kur ti përfundojë mandati anëtarëve aktual, anëtarët e rinjë të jenë të zgjedhur. Po ashtu duhet të shikohet edhe neni 21A, që flet për ekonomizimin në aktivitetet e prokurimit. Unë jam për këtë ekonomizim për prokurimin, por duhet të kemi kujdes se me prizin e ekonomizimit mos të shkaktojm probleme tjera të mëdha. Siç është i rregulluar aktualisht, që për agjencitë e pavarura që kanë më pak se 50 punonjës, procedurat e prokurimit ti kryej Kuvendi, kjo krijon probleme dhe është vështirë e zbatueshme, kur dihet se ekzistojnë 35 agjencione të këtilla dhe Kuvendi nuk ka kapacitetet e nevojshme për ta bërë këtë punë. Duhet të rregullohet kjo qështje, të shtohen kapacitetet e zyrës së prokurimit në Kuvend ose për agjencitë që nuk kanë njësi të prokurimit, aktivitetet e prokurimit të mund ti kryej Agjencia Qendrore e Prokurimit. Prandaj, unë propozoj që të formojmë një grup punues që bashkërisht me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, me Ministrinë, kryetarin e KRPP-së ti analizojmë të gjitha këto qështje dhe të bëjmë rregullimet e nevojshme që të miratojm një ligj të mirë.

Besa Gaxherri - duhet ta kemi parasysh që vërtet e kemi një ligj të rëndësishëm shumë të veçantë, që ne pretendojmë me e luftue korrupsionin dhe ky ligj është shumë i rëndësishëm në këtë drejtim. Përkundër presionit të kohës që kemi, duke ditur rëndësinë e tij, ne duhet të punojmë seriozisht dhe intenzivisht që të miratojmë një ligj të mirë. Ne duhet gjetur mundësitë dhe mbështetjen profesionale dhe teknike, dhe në qoftë se është nevoja me punue deri në mbrëmje, të bëjmë rregullimet dhe ndryshimet e nevojshme në mënyrë që ti kemi gati amendamentet kur të bëhet shqyrtimi i dytë.

Kryetari – në këtë ligj gjatë viteve kemi punuar shumë dhe kemi dasht që të jetë një ligj i zbatueshëm, por ka pasur edhe ndërhyrje të jashtëzakonshme nga jashtë dhe është dashur të ndryshojmë dhe plotësojmë disa herë. Por meqë miratimi i këtij ligji tani është kusht që lidhet me kriteret për liberalizimin e vizave, na detyron që nesër me kërkue shmangien e Rregullorës për procedim me procedurë të përshpejtuar. Ne do të punojmë sa të kemi kohë dhe mundemi për të bërë ndryshimet e nevojshme për lexim të dytë.

Bardhyl Meta – me rastin e shqyrtimi të projektligjit në muajin dhjetor, ne e kemi shikuar me kujdes dhe kemi bërë ndryshime substanciale. Tjetër është se tani ka pas vërejtje e sugjerime dhe asnjë prej këtyre vërejtjeve nuk e shuan luftën kundër korrupsionit, por e bënë më të adaptueshme me legjislacionin evropian.

Kryetari - ky është ligj për prokurimin publik e nuk është ligj luftën kundër korrupsionit. Janë institucionet tjera të pavarura që merrem me zbatueshmërinë apo keqpërdorimin e ligjit, por ne duhet me bërë një ligj të mirë.

Safet Hoxha - gabimet që janë lëshuar në ligjin paraprak janë më shumë teknike se sa përmbajtësore. Ndryshimet që janë bërë kanë arritur me ndryshue qasjen formaliste ne një qasje më pragmatike. Propozimet tona që i paraqita janë të qarta dhe në përputhshmëri me direktivat e BE-së.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe Ligjin nr. 05/L-068.
2. I rekomandohet Kuvendit për shmangien e Rregullores së Kuvendit, për shqyrtimin e parë dhe të dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe Ligjin nr. 05/L-068.
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe Ligjin nr. 05/L-068, të bëhet në Seancën Plenare të datës 19.02.2016, dhe shqyrtimi i dytë të bëhet në Seancën e re Plenare, ditën e sotme, më datë 19.02.2016.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtari Minerare dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Kryetari - Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Si dhe as amendamentet e komisionit funksional nuk prodhojnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji Nr.05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin Nr.05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
5. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-064 për Patentë Shofer dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Kryetari - projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Si dhe as amendamentet e komisionit funksional nuk prodhojnë kosto shtesë buxhetore.

Besa Gaxherri - ligji për patent shofer është në rregull. Por për vendimin që është marrë për qmimin për patent shofer, ne duhet si komision funksional që jemi të marrim një qendrim dhe t'ia dërgojmë qeverisë dhe të këkojmë që atë vendim me e shfuqizue, sepse është krejtësisht i pa arsyeshëm.

Kryetari – qështja që ngriti parafolësja, mundet të ngritet nga deputetët në seancë.

Besa Gaxherri – unë mendoj që kemi mandat edhe mundësi me kërkue prej qeverisë që me e shfuqizue atë vendim. Prandaj unë kam një propozim konkret dhe komisioni duhet të vendos. Kalon apo jo është qështje tjetër.

Kryetar – komisioni që përfaqësojmë, vlerëson koston buxhetore dhe atë që është e shkruar në projektligj dhe ne nuk mund të ndërhyjmë në qështjet tjera, se nuk është në mandatin tonë.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji 05/L-064 për Patentë Shofer, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin Nr.05/L-064 për Patentë Shofer nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit

Kryetari - projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Si dhe as amendamentet e komisionit funksional nuk prodhojnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji Nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, për Projektligjin nr.05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani